

FJALA E DEPUTETIT ILIR METAJ

E HËNË 23 MAJ 2022

Ja ku jemi sot këtu, ashtu siç nuk duhej të ishim: me një opozitë pa opsione, përballë një vendimi madhor për vendin, dhe me një fatunë në gotë për kompensim. I mençuri dhe i marri nuk marrin këshilla, i pari, se nuk ka nevojë; i dyti, se mendon që nuk ka nevojë. Çështja është a e di i marri këtë diferencë?! Fatkeqësisht, jo. Përkundrazi, mendon se edhe ai nuk ka nevojë për këshilla, por diferenca është aty, është larg vite drite dhe qëndron pikërisht në me mes të tyre! Ne, socialistet, jemi të gatshëm të dëgjojmë këshillat e të mençurve dhe kjo na bën të ditur, jo të marrë.

Të mençurit e kanë kthyer çdo grimcë të trojeve të tyre në pasuri dhe këtë pasuri e kanë lenë trashëgimi brez pas brezi. Janë të mençurit që e kthyen Versajën, Shonbrunin, Koloseun, Akropolin në burim të ardhurash të pashtershme për brezat që do të vijnë. Ato u kthyen në burim të ardhurash përmes këshillave të më mençurve. Pikërisht këtë po bëjmë edhe ne sot: të mësojmë se si menaxhohet, pa dëmtuar vlera, por përkundrazi, duke i zbuluar vlerat. Butrinti është një gjigant kulturor për ne dhe për botën mbarë, por ne duhet ta shndërrojmë atë edhe ne një gjigant ekonomik për vendin tonë, duke bërë të mundur që çdo gur i tij të prodhojë të ardhura, sepse për Butrintin vlen të paguhet për t'u soditur çdo gur i tij, për t'u kuptuar dhe për t'u lexuar. Ne duhet ta shndërrojmë këtë gjigant ekonomik dhe ka ardhur koha që të bëhemi më të ditur, që ta bëjmë sa mirë këtë shndërrim.

Shqipëria nuk e ka luksin t'i lerë toka djerrë, të lerë pasuri djerrë. Ne duhet të mësojmë nga kombet e mëdha se si ato mbrohen duke shfrytëzuar, ndërtojnë duke jetuar, plotësojnë peizazhe, duke përbashkuar gjithë të mirat që Zoti i ka dhënë kësaj toke. Nuk është mençuri t'u largohesh punëve nga frika se mos bën keq, por është mençuri të marrësh këshillat e duhura para se ta fillosh punën, pastaj të guxosh duke qene edhe pragmatist. Të jesh pragmatist për të mirën e popullit tënd, të brezit sot dhe të atyre që do të vijnë, nuk është mëkat. Përkundrazi, është detyrë për çdo qeveri, sepse qeveritë vijnë të krijojnë vlera të reja, jo thjesht të lënë çdo gjë, siç e kanë gjetur më parë. A e kemi menaxhuar Butrintin në standardet e duhura deri më sot?

Nuk besoj se kjo është një nga pikat më të forta që ne mund të mburremi. Butrinti deri sot ka qenë një kryefjalë e kulturës sonë, por nuk ka qenë asnjëherë një kryefjalë e turizmit shqiptar. Mendoj se këtë synim ka projekti i ri i Ministrisë së Kulturës për Butrintin. Këtë iniciativë të re unë e lexoj kështu: një

këshillë e marrë nga të mençurit për ta kthyer më në fund Butrintin, nga një bukuri e fjetur, në një bukuri të gjallë mes nesh, sepse ne pranojmë këshilla, kurse të marrët tanë nuk pranojnë këshilla as në shqip dhe as në anglisht. Për sa kohë që emri i tyre nuk është mbi tryezën e këshillave të mira, ajo tryezë duhet përmbysur me çdo kusht dhe me çdo kosto. Pastaj në ndihmë thirret primitivizmi, sedra e lënduar apo mllefi homofob.

Ndaj vijnë sot këtu me fletë të bardhë për Presidentin dhe me fletë të nxirë për Butrintin, por në këtë fletë të nxirë unë shquaj vetëm një gjë: mbështetjen e popullit amerikan, i cili kërkon çdo rrugë për të trokitur në derën e këtij vendi. Në këtë rast, përmes Parkut Arkeologjik të Butrinti, ne duhet të ndihemi të nderuar që e hapim këtë derë, sepse e dimë se asnjë para e taksapaguesve amerikane nuk i jepet një partneri të padenjë. Ky është një tjetër vlerësim për qeverinë socialiste. Ne duhet të bëjmë dallimin se kush është i marri dhe kush është i mençuri dhe t'i japim vendin që i takon secilit. Ne, të zakonshmit, mund të mos jemi dot të mençur, por të ditur mund të bëhemi duke dëgjuar më të diturit, sidomos ata të ditur që e kanë bërë vendin e tyre shembull demokracie e zhvillimi, duke filluar nga zero, madje kanë qenë me ne sot prej 100 vjetësh, sa herë kemi pasur e nevojë për një mbrojtës të madh.

Nëse ka një gjë që shqiptarët, kudo që janë në botë, është se kujt duhet t'i falënderohen që sot janë të lirë e të pavarur. Së fundi, po e mbyll me një shprehje jo vetëm për Butrintin, por edhe për Presidentin e më gjerë, në fakt, një shprehje që është e njëjtë si në Bibël, ashtu edhe në Kuran: “Le ta marrë drejtimin i dituri”. Faleminderit!